



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 901/3 Prot.

Tiranë, më 30.9 2016

REKOMANDIM

Nr. 18 datë 30.9 2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë". Zyra e Komisionerit ka kryer hetim administrativ në ngarkim të kontrolluesit, *Drejtoria Arsimore Rajonale Qytet Tiranë*, me aktivitetin e tij në formën ligjore persona juridikë.

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhërit Nr. 181, datë 30.08.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të dalë për realizimin e këtij hetimi administrativ, nga grupi i inspektimit u realizua kontrolli, pranë kontrolluesit *Drejtoria Arsimore Rajonale Qytet Tiranë*, konform procedurave administrative me objekti kontrolli si më poshtë:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit *Drejtoria Arsimore Rajonale Qytet Tiranë*, i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhërin Nr.181, datë 30.08.2016 të Komisionerit.

**Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:**

1. Kontrolluesi nuk e ka kryer "Njoftimin" në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të nenit 21-22 të ligjit.
2. Kontrolluesi ka rregullore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale por në shkollën e mesme "Qemal Stafa", dhe atë speciale "Instituti i nxënësve që nuk dëgjojnë", nuk u konstatua një rregullore e tillë, si detyrim që buron prej nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, dhe Udhëzimit Nr. 12/2015 të M.A.S.

3. Kontrolluesi nuk aplikon deklaratën e konfidencialitetit me punëmarrësit mësues, psikologë, punonjës social etj.
4. Konstatohet se D.A.R. Qytet Tiranë, administron vetëm një adresë zyrtare të postës elektronike (e-Mail) dhe të gjithë punëmarrësit komunikojnë nëpërmjet postës elektronike personale ndërmjet njëri-tjetrit. Adresa e postës elektronike mundësohet nga M.A.S.
5. Konstatohet se dosjet personale të krijuara nga psikologët ruhen për një periudhë të pacaktuar pasi koha e ruajtjes së të dhënave nuk është e përcaktuar në rregullore apo udhëzime specifike.
6. Konstatohet se në kartelat/dosjet personale të punëmarrësve ndodhen të dhëna dhe përshkrime në një afat mbi 30-vjeçar të cilat kanë të bëjnë me opinione dhe përshkrime politike për subjektin e të dhënave.

**Faktet e sipërme përbëjnë shkelje administrative të neneve 5, 21, 22, 27 dhe 28 të Ligjit nr. 9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.**

**Në cilësinë e provës materiale, këtij procesverballi i bashkëngjiten këto dokumente:**

- Rregullore e për Mbrojtjen e të dhënave personale në D.A.R. Qytet Tiranë.
- Rregullore e brendshme për mbarëvajtjen e punës në Institutin e nxënësve që nuk dëgjojnë.
- Tre praktika të krijuara nga psikologu për nxënësit me probleme të ndryshme.
- Formular i përshkrimit të punës për pozicionin e punës përgjegjës i sektorit të IT-së.
- Formular i përshkrimit të punës për pozicionin e punës specialist i sektorit të IT-së.
- Ekstrakt nga rregullorja e përgjithshme në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e sektorit të IT-së.
- Tabelë e publikimit të listës së aplikantëve dhjetor 2015-16.05.2016.
- Tabela renditëse përfundimtare e aplikantëve për mësues.

Në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, por veçanërisht dhe në mbështetje të Udhëzimit të MAS-it Nr.12, datë 27.04.2015 “Për mbledhjen përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare dhe të nxënësve, si dhe përmbajtjen e dosjeve të tyre personale”, duhej të ishin marrë masat e duhura, ato më thelbësoret.

Fakti që kontrolluesi ka një rregullore formale, nuk e justifikon ekzistencën e saj, duke mbetur fiktive, për arsye se kontrolluesi:

- 1-Nuk ka kryer Njoftimin;
- 2-Nuk aplikon Deklaratën e Konfidencialitetit, (pika 14, gërma “b”), sipas këtij udhëzimi.
- 3-Nuk realizon informimin e subjekteve të të dhënave në ambientet e shkollave që monitorohen nga sistemi CCTV, (pika 8, gërma “b”).



Në përmbyllje të procesit administrativ, në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit u hartua dhe lexua procesverbali i mbajtur për këtë rast. Nga ana e tyre, përfaqësuesit e kontrolluesit nuk paraqitën pretendime, por u shprehën se do përmbushin konstatimet e dala nga proces verbali dhe do i paraqesin ato gjatë seancës dëgjimore.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit Nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", datë 30.04.2015, në datë 23.09.2016, përpara marrjes së vendimit përfundimtar, është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të kontrollit administrativ.

Në seancë dëgjimore, përfaqësuesit e kontrolluesit D.A.R. Qytet Tiranë u paraqitën në ushtrim të së drejtës së tyre për tu dëgjuar, duke vënë në dispozicion të Zyrës së Komisionerit masat e menjëherëshme të marra nga kontrolluesi, mbi rikuperimin e shkeljeve të konstatuara prej grupit të inspektimit.

Zyra e Komisionerit konkludon se, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, janë rikuperuar brenda një afati kohor të shkurtër, si dhe bashkëpunimi i kontrolluesit me grupin e hetimit ka qënë i ndërsjellë në funksion të zbatimit të ligjit.

Sa më sipër:

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar dhe në kuadër të problematikave të hasura pranë këtij kontrolluesi,

#### **REKOMANDOJ:**

1. Kontrolluesi Drejtoria Arsimore Rajonale Qytet Tiranë, në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, të marrë masat për të realizuar detyrimin e informimit të subjekteve të të dhënave, në të gjitha institucionet arsimore, kryesisht në shkollat e pajisura me sistem kamerash vëzhguese.
2. Kontrolluesi Drejtoria Arsimore Rajonale Qytet Tiranë, në zbatim të nenit 21 dhe 22 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, të ketë vëmendje përditësimin e formularit të njohimit, për të gjitha proceset e reja të mundshme në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.
3. Kontrolluesi Drejtoria Arsimore Rajonale Qytet Tiranë, në zbatim të nenit 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, të marrë masat për të realizuar Deklaratat e Konfidencialitetit, për të gjithë punonjësit e institucioneve arsimore, të cilët aksesojnë të dhëna personale gjatë ushtrimit të detyrës në këto institucione.
4. Kontrolluesi Drejtoria Arsimore Rajonale Qytet Tiranë, duhet të realizojë detyrimet rekomanduese të këtij akti, brenda një afati kohor prej 3 (tre) muajve nga dalja e tij.
5. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008. "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i

ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë, 30 . 9 .2016

